



Tax Alert Albania

August 2024





Notice No. 1404, dated 30.1.2024 "On the entry into force of a bilateral agreement with the Slovak Republic"

The international agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the government of the Slovak Republic on the elimination of double taxation, in relation to income taxes and the prevention and avoidance of tax evasion, signed on 30 May 2023, in Bratislava, entered into force on 1 April 2024.

Source: Official Gazette No. 23, date 07.02.2024 ([Link](#))

Njoftim Nr. 1404, datë 30.1.2024 "Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Republikën e Sllovakisë"

Marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovakisë për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin, dhe shmangien e evazionit tatimor, nënshkruar më 30 maj 2023, në Bratislavë, hyri në fuqi më datë 1 prill 2024.

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 23, datë 07.02.2024 ([Link](#))

Law No. 11/2023 "On the ratification of the agreement between the Republic of Albania and the Republic of Croatia on social protection" and Notice No. 7233, dated 8.5.2024 "On the entry into force of the international agreement"

The agreement between the Republic of Albania and the Republic of Croatia on social protection has been ratified and has entered into force on 1 May 2024.

Source: Official Gazette No. 38, dated 27.02.2024 ([Link](#))

Source: Official Gazette No. 83, dated 14.05.2024 ([Link](#))

Ligj Nr. 11/2023 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë për mbrojtjen shoqërore" dhe Njoftim Nr. 7233, datë 8.5.2024 "Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare"

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë për mbrojtjen shoqërore, është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi datë 1 maj 2024.

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 38, datë 27.02.2024 ([Link](#))

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 83, datë 14.05.2024 ([Link](#))

Law No. 47/2024 "On the ratification of the agreement between the Republic of Albania and the Republic of Italy in the field of social security"

The agreement between the Republic of Albania and the Republic of Italy in the field of social insurance has been ratified.

Source: Official Gazette No. 103, dated 21.06.2024 ([Link](#))

Ligj Nr. 47/2024 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në fushën e sigurimeve shoqërore"

Është ratifikuar marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në fushën e sigurimeve shoqërore.

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 103, datë 21.06.2024 ([Link](#))

Law No. 91/2024 "On some changes in the law no. 7961, dated 12.7.1995, "Labor Code of the Republic of Albania", amended"

Annual holidays, according to the Labor Code of the Republic of Albania must last no less than 22 working days (changed from "4 calendar weeks"). The changes provide that annual vacations can be taken intermittently (removed the obligation to be at least one calendar week without interruption).

Source: Official Gazette No. 143, dated 09.08.2024 ([Link](#))

Ligj Nr. 91/2024 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"

Pushimet vjetore, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë duhet të zgjasin jo më pak se 22 ditë pune (ndryshuar nga "4 javë kalendarike"). Ndryshimet parashikojnë se pushimet vjetore mund të merren edhe me ndërprerje (hequr detyrimi për të qenë të paktën një javë kalendarike pa ndërprerje).

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 143, datë 09.08.2024 ([Link](#))



Law No. 76/2024 "On some changes and additions to the law no. 61/2012, "On excise duties in the Republic of Albania", amended

The authorized public legal person for the production and distribution of fiscal stamps will assume the role of the concessionaire of the fiscal stamps.

The price for each fiscal stamp produced and distributed by the authorized public legal entity is determined by the decision of the Council of Ministers, and is paid by all manufacturers and importers who are required by law to apply the fiscal stamp.

Fiscal stamps ordered from the concessionaire and approved by the General Directorate of Customs until 31 December 2024 are allowed to be sent to the manufacturer or supplier until 31 March 2025.

Excise products with fiscal stamps ordered from the concessionaire and approved by the General Directorate of Customs until 31 December 2024, will be allowed to enter the market for consumption within 1 year from the date of sending the fiscal stamp to the manufacturer or the supplier.

The law extends its effects from 1 January 2025.

Source: Official Gazette No. 139, dated 07.08.2024 ([Link](#))

Ligj Nr. 76/2024 'Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

Rolin e koncesionarit për pullat fiskale do e ketë personi i autorizuar juridik publik për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale.

Çmimi për çdo pullë fiskale të prodhuar dhe të shpërndarë nga personi i autorizuar juridik publik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe paguhet nga të gjithë prodhuesit dhe importuesit, të cilëve sipas ligjit u kërkohet të aplikojnë pullën fiskale.

Pullat fiskale të porositura tek kompania koncesionare dhe të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave deri më 31 dhjetor 2024 lejohen të dërgohen tek prodhuesi apo furnizuesi deri në datën 31 mars 2025.

Produktet e akcizës, në të cilat janë trupëzuar pullat fiskale të porositura tek kompania koncesionare e të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave deri më 31.12.2024, do të lejohen të hidhen për konsum brenda 1 viti nga data e dërgimit të pullës fiskale tek prodhuesi apo furnizuesi.

Ligji i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 139, datë 07.08.2024 ([Link](#))

Decision No. 52, dated 27.6.2024 of the Constitutional Court of the Republic of Albania, following the review session on 18.6.2024 and 25.6.2024, on the request for repeal of some articles of Law No. 29/2023.

The object of this decision was:

- repeal of articles 24, item 2
- repeal of Article 69, point 1, letter "dh", second and third sentences, of law no. 29/2023 "On income tax", amended,
- partial repeal of Article 3, point 5
- partial repeal of Article 12, point 1, letter "ç",
- repeal of Article 4 and analytical table no. 2 of decision no. 753, dated 20.12.2023 of the Council of Ministers "On the implementing provisions of law no. 29/2023 "On income tax".

The Constitutional Court of the Republic of Albania decided to partially accept the request, canceling points "b" and "e" above, and dismissed the other requests.

As a result, physical persons and entities that supply professional services, with an annual turnover of up to ALL 14 million, will continue to be subject of 0% income tax rate until 31 December 2029.

Source: Official Gazette No. 136, dated 05.08.2024 ([Link](#))

Vendim Nr. 52, datë 27.6.2024 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në vijim të seancës shqyrtuese më datë 18.6.2024 dhe 25.6.2024, mbi kërkesën për shfuqizim të disa neneve të Ligjit Nr. 29/2023.

Objekt i këtij vendimi ishte:

- shfuqizimi i neneve 24, pika 2
- shfuqizimi i nenit 69, pika 1, shkronja "dh", fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar,
- shfuqizimi i pjeshëm i nenit 3, pika 5
- shfuqizimi i pjeshëm i nenit 12, pika 1, shkronja "ç",
- shfuqizimin e nenit 4 dhe tabelës analitike nr. 2 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë vendosi pranimin e pjeshëm të kërkesës, duke shfuqizuar pikat "b" dhe "e" më sipër, dhe ka rrëzuar kërkesat e tjera.

Kështu, të vetëpunësuarit dhe entitetet të cilët furnizojnë shërbime profesionale, me të ardhura bruto deri 14 milione lekë, do të vazhdojnë të jenë subjekt i normës së tatim fitimit prej 0%.

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 136, datë 05.08.2024 ([Link](#))



Instruction No. 11, dated 23.7.2024 "On the implementation of agreements for the avoidance of double taxation and the prevention of fiscal evasion"

The application and approval procedure for the implementation of agreements for the avoidance of double taxation (DTT) has changed.

The taxpayer resident in Albania notifies the tax administration of the implementation of the DTT, by uploading online in the tax system (e-tax) the documentation that proves the implementation of the Agreement, within the deadlines defined in the law "On tax procedures in the Republic of Albania".

The notification does not constitute a request for approval by the DPT, but may be subject to a tax inspection by the regional tax directorates, according to the legal procedures, based on the risk profiles provided for in this Instruction.

Within the first six months of 2025, until the e-tax system is configured to allow for such a new procedure, the taxpayer will be able to submit the documentation in a hard copy format, as well as in electronic format with CD/USB. Applications previously filed (before the entry into force of the Instruction) will continue to be followed up with GDT as before, until they are finalized.

The documentation to be submitted is listed below:

- The online form (digital declaration), signed or not by the non-resident taxpayer.
- Service contracts with the non-resident company, in the language(s) signed by the parties.
- Certificate of residence for the supplier (person not resident in Albania), issued by the authorities in the country of residence, translated into Albanian (electronic form or on paper).
- An analytical list in tabular and summary form of foreign invoices (invoice number and date, description, etc.) issued by the tax resident in the other country.
- An analytical list in tabular and summary form of information on payments made by the taxpayer resident in Albania.

Source: Official Gazette No. 133, dated 01.08.2024 ([Link](#))

Decision No. 513 dated 1.8.2024 "On determining the procedures and detailed information contained in the country-by-country reporting regarding groups of multinational companies"

This decision defines the detailed procedures and information, that contains the country-by-country reporting (CbC Reporting) in relation to groups of multinational companies. The report for each country contains the information provided in the tables of this decision, and their completion is done in accordance with the definitions and guidelines for each table.

The data reported in the respective tables cover the fiscal year of the reporting entity, and reflect information for the fiscal year of the respective multinational entities.

Source: Official Gazette No. 144, dated 12.08.2024 ([Link](#))

Udhëzim Nr. 11, datë 23.7 2024 "Për zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal" ("MSHTD"-ve).

Ndryshojnë procedurat e aplikimit dhe miratimit të zbatimit të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë (MSHTD).

Tatimpaguesi rezident tatimor në Shqipëri njofton administratën tatimore për zbatimin e MSHTD-së, duke ngarkuar online në sistemin informatik tatimor (e-tax) dokumentacionin që provon zbatimin e Marrëveshjes, në afatet e përcaktuara në ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Njoftimi nuk përbën një kërkesë për miratim nga DPT, por mund të jenë subjekt i kontrollit tatimor nga drejtoritë rajonale tatimore, sipas procedurave ligjore, bazuar në profilet e riskut parashikuar në këtë Udhëzim.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, deri në përshtatjen e sistemit e-tax për të bërë efektiv dorëzimin, tatimpaguesi do të mund ta dorëzojë dokumentacionin në format letër hard copy, si dhe format elektronik me CD/USB. Aplikimet e vjetra të depozituara (para hyrjes në fuqi të udhëzimit) do vazhdojnë të ndiqen me DPT si më parë, deri në finalizimin e tyre.

Dokumentacioni që duhet dorëzuar listohet si më poshtë:

- Formularin online (deklaratë e digjitalizuar), i firmosur ose jo nga tatimpaguesi jorezident.
- Kontratat e shërbimit me kompaninë jorezidente, në gjuhën/gjuhët që janë nënshkruar nga palët.
- Certifikatën e rezidencës për furnitorin (personin jorezident në Shqipëri), lëshuar nga autoritetet në shtetin e rezidences, përkthyer në shqip (formë elektronike apo në letër).
- Një listë analitike në formë tabelare dhe përmbledhëse të faturave të huaja (numër dhe datë e faturës, përshkrimi etj.) të lëshuara nga rezidenti tatimor në shtetin tjetër.
- Një listë analitike në formë tabelare dhe përmbledhëse e informacioneve mbi pagesat e kryera nga tatimpaguesi rezident tatimor në Shqipëri.

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 133, datë 01.08.2024 ([Link](#))

Vendim Nr. 513 datë 1.8.2024 "Për përcaktimin e procedurave dhe të informacionit të detajuar, që përmban raporti për çdo vend në lidhje me grupet e shoqërive shumëkombëshe"

Ky vendim përcakton procedurat dhe informacionin e detajuar, që përmban "raporti për çdo vend" në lidhje me grupet e shoqërive shumëkombëshe. Rraporti për çdo vend përmban informacionin e dhënë në tabelat e këtij vendimi, dhe plotësimi i tyre bëhet në përputhje me përkufizimet dhe udhëzuesin për secilën tabelë.

Të dhënat e raportuara në tabelat përkatëse mbulojnë vitin fiskal të entitetit raportues, dhe pasqyrojnë informacion për vitin fiskal të entiteteve përbërëse përkatëse.

Burimi: Fletore Zyrtare Nr. 144, datë 12.08.2024 ([Link](#))



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

 +355 4 22 90 700

 al_pwc_albania@pwc.com

 www.pwc.com/al

